



## KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

### Zyrtar për logjistikë

Zyrtari për Logjistikë është përgjegjës për kryerjen e punëve logjistike që dalin nga kërkesat/nevojat e përditshme të zyrës dhe do t'i raportojë Administratorit të Zyrës;

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për mirëmbajtjen teknike të zyrave, sallave, veturës zyrtare, gjeneratorit;
- Përgjegjës për furnizimin e zyrës sipas kërkesës nga departamenti i administratës;
- Përgjegjës për vozitjen e veturës zyrtare për nevojat e zyrës;
- Përgjegjës për përgatitjen, printimin dhe shpërndarjen e ID kartelave të studentëve dhe anëtarëve;
- Përgjegjës për pranimin dhe shpërndarjen e materialeve për trajnime (ligjërata, seminare etj.);
- Mbledhë dhe shpërndanë dokumente sipas kërkesës së personelit;
- Përkujdeset dhe mirëmban pajisjet e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Bashkëpunon me departamentet tjera si dhe kryen detyra dhe përgjegjësi tjera sipas kërkesës;

#### Kualifikimet dhe përvoja:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Patenta e shoferit e kategorisë "B";
- Njohuri në kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferuar;
- Aftësi të mira komunikuese dhe reprezentative;
- Aftësi organizative për punë të pavarur.

Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: [info@scaak.org](mailto:info@scaak.org)

Për pozitën: Zyrtar për Logjistikë

CV-të i pranojmë deri më 11 janar 2019

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.